

| | |
|-----------------|---------------------------|
| Pranda: m.v. d. | 18.7.2022 |
| Nj. org. | No. 17 - N. exempl. Vlera |
| 01 | 1/672 |



KOMUNA E GJAKOVËS

publika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Prejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë
Uprrava za Opštë, Administrativne Poslove

01 Nr.B/ 1361-18205
19.07.2022

Data/Datum
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

KOMUNËS SË GJAKOVËS

dhe

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

1. QËLLIMI

Marrëveshja përcakton kornizat e bashkëpunimit institucional ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në fushat e interesit të përbashkët, në pajtim me kompetencat ligjore të tyre.

2. OBJEKTIVAT

Palët nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshje pajtohen që të bashkëpunojnë në hartimin, aplikimin dhe zbatimin e projekteve, elaborateve dhe studimeve të përbashkëta, organizimin dhe realizimin e forumeve profesionale në fushat relevante për palët, realizimin e këshillimeve profesionale reciproke, ofrimin e mundësive për realizimin e praktikës profesionale për studentët, harmonizimin e përmbajtjeve mësimore me nevojave e tregut të punës, funksionalizimin e institucioneve të përbashkëta profesionale dhe shkencore.

3. AKTIVITETET

Me qëllim të realizimit të objektivave të marrëveshjes, palët do të:

- a) Bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet për planifikimin dhe zbatimin e projekteve profesionale, elaborateve, studimeve profesionale dhe kërkimeve shkencore në fushat e interesit të përbashkët
- b) Koordinohen lidhur me organizimin e konferencave, punëtorive dhe trajnimeve profesionale dhe shkencore
- c) Realizojnë takime të grupeve profesionale me qëllim të konsultimit lidhur me plotësimin/ndryshimin e kornizës strategjike dhe ligjore në fushat e interesit të përbashkët
- d) Bashkëpunojnë në përcaktimin e kushteve dhe kuotave të studentëve për realizimin e praktikës profesionale
- e) Funksionalizojnë trupat këshillëdhënëse profesionale në funksion të reformimin të përmbajtjes së programeve dhe lëndëve mësimore, me qëllim të harmonizimit të tyre me nevojat e tregut të punës
- f) Krijojnë, funksionalizojnë dhe zhvillojnë institacione të përbashkëta profesionale dhe shkencore, në funksion të realizimit të projekteve, studimeve dhe trajnimeve në fushat e interesit të përbashkët
- g) Planifikojnë, hartojnë dhe realizojnë programe të trajnimeve të ekipeve të specializuara me qëllim të krijimit të sistemit të qëndrueshëm të trajnimeve të palëve të treta

- h) Realizojnë trajnime dhe certifikime profesionale të palëve të treta, në fushat e interesit të përbashkët.

4. TRAJTIMI I TË DHËNAVE

Palët pajtohen që informatat, dokumentet apo të dhënat që burojnë nga zbatimi i marrëveshjes, do të përdoren në funksion të realizimit të qëllimit të saj, në pajtim me dispozitat ligjore.

5. PRONËSIA INTELEKTUALE

E drejta e pronësisë intelektuale lidhur me ndonjë zhvillim që buron nga zbatimi i marrëveshjes trajtohet sipas ligjit përkatës për të drejtat autoriale.

6. AUTORITETET ZBATUESE

Realizimi i objektivave të marrëveshjes do të bëhet nga:

- a) Komuna e Gjakovës - Drejtoritë përkatëse
- b) Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”- Fakultetet dhe Qendrat përkatëse

7. MARRËVESHJET EKZEKUTIVE

Me qëllim të realizimit të aktiviteteve të parapara në këtë marrëveshje dhe sipas nevojës, Komuna e Gjakovës dhe UP/ Fakultet/ Qendrat përkatëse mund të nënshkruajnë marrëveshje tjera specifike me karakter ekzekutiv.

8. NDRYSHIMET

Varësisht nga nevoja, marrëveshja mund të plotësohet apo ndryshohet dhe në atë rast plotësimi/ ndryshimi bëhet në formë të shkruar dhe konsiderohet si aneks i veçantë i kësaj marrëveshje.

9. ZGJIDHJA E MOSPAJTIMEVE

Marrëveshja shpreh vullnetin e mirë të palëve për bashkëpunim në fushat e interesit të përbashkët, prandaj mospajtimet eventuale gjatë zbatimit të saj zgjedhën me respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë.

10. KOHËZGJATJA DHE MËNYRA E PËRFUNDIMIT

Marrëveshja nuk është e kufizuar në aspektin kohor, por mund të përfundojë me kërkesën me shkrim nga cilado prej palëve nënshkruese, me një paralajmërim prej së paku 30 ditëve. Në rast të përfundimit, palët pajtohen që të përmbyllin aktivitetet tashmë të filluara, përveç në rastet ku një gjë e tillë nuk është e mundur për shkaqe objektive.

11. HYRJA NË FUQI

Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

12. KOPJET

Marrëveshja është e hartuar në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë nënshkruese pajiset me një kopje originale të nënshkruar.


PALËT NËNSHKRUËSE

Ardian GJINI


Kryetar i Komunës së Gjakovës



Prof. dr. Naser SAHITI



Nënshkruar në Prishtinë me datë:

18/07/2022